



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201602527/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandojmë marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar".*

**Drejtuar:** **Z. Blendi KLOSI**  
**Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë**

**TIRANË**

***I nderuar zoti KLOSI,***

Në përmbushje të detyrës sonë kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar si dhe një institucion që sipas ligjit nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar", është monitorues i zbatimit të këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", ka konstatuar se ende nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore për ta bërë të zbatueshëm ligjin.

Në nenin 21 të ligjit të sipërcituar thuhet shprehimisht se:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 3, dhe 17, pika 2, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, dhe 11, pika 3, brenda 6 muajve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3, 7, pika 3, 10, pika 5, dhe 20, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
2. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të pikës 3, të nenit 8, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Rezulton se që nga hyrja në fuqi e ligjit ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3, nenit 7/pika3, nenit 10/pika5, nenit 8/pika4 si dhe Udhëzimi në zbatim të nenit 8/pika3 sipas afateve ligjore të përcaktuara në dispozitë. Konkretisht:

-Në nenin 6- **Shërbimet për një jetesë të pavarur**- pika3, thuhet se:  
“3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Në nenin 7- **Vendimmarrja e mbështetur** -pika3, thuhet se:  
“3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Në nenin 10- **Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje**- pika5, thuhet se:

“5. Ngritja, administrimi, procedurat e vlerësimit, organizimi e funksionimi i komisionit dhe ankimet e vendimeve rregullohen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.”

- Në nenin 8- **Ndihmësi personal**- pika 3 dhe 4, thuhet se:  
“3. Mënyrat e përfitimit të formimit të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen në një udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar.

3. Mënyra e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Mosmiratimi i këtyre akteve nënligjore bën që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në dispozitat ligjore të sipërcituara të mos gjejnë zbatim.

Qëllimi i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, që është nxitja, mbrojtja dhe të sigurimi, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, për të balancuar disavantazhin e thellë shoqëror, në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuara dhe të mundësojë pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar” ka përcaktuar se:

“Shtetet palë marrin përsipër:

(a) Të mundësojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo konventë”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 118 ka përcaktuar se aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet përkatëse dhe në këtë rast, organi i cili duhet të nxjerrë aktet nënligjore të sipërcituara është institucioni që Ju drejtoni.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: “Avokati i Popullit

*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË:**

*Marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3, nenit 7/pika3, nenit 10/pika5, nenit 8/pika4, nenit 8/pika3 të Ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, ku thuhet shprehimisht se;

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve”.*

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, mbetemi në pritje të përgjigjes.

**Me respekt**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**